




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Rezultatet a Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve (2008 - 2010)



ENTI I STATISTIKËS SË KOSOVËS
ZAVOD ZA STATISTIKU KOSOVA
STATISTICAL OFFICE OF KOSOVA



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Rezultatet a Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve (2008 - 2010)



ENTI I STATISTIKËS SË KOSOVËS
ZAVOD ZA STATISTIKU KOSOVA
STATISTICAL OFFICE OF KOSOVA

Botuesi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)
Data e botimit: Qershor 2012
© : Agjencia e Statistikave të Kosovës
Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.
E shtypur nga: K.G.T, Prishtinë, Kosovë

Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qaseni përmes veb-faqes së ESK-së
në internet: <http://esk.rks-gov.net>

P a r a t h ë n i e

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) gjegjësisht departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare ka përgatitur publikimin e rezultateve të Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve (ASN) për periudhën 2008 - 2010
Hulumtimi i ASN-së për herë të parë ka filluar në vitin 2006 për vitin referues 2005. Nga viti 2005 e kënde ky hulumtim është pjesë përbërëse e Programit statistikor të ASK-së dhe bazohet në deklaratimet e ndërmarrjeve.
Kjo anketë me të dhënat që ofron, synon të paraqet disa nga treguesit ekonomik sipas strukturës së veprimtarive ekonomike.

Rezultatet e këtij hulumtimi në të njëjtën kohë përdoren për nevoja të llogarive kombëtare dhe janë burim i rëndësishëm në përpilimin e Bruto Produktit Vendor me qasjen e prodhimit.

Ky publikim është i treti me radhë i kësaj natyre me intencë të vazhdueshme që të jetë publikim i rregullt i ASK-së.

ASK falënderon të gjitha ndërmarrjet që treguan nivel të lartë të bashkëpunimit. Gjithashtu falënderojmë Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) dhe Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) për bashkëpunim institucional.

Komentet dhe sugjerimet tuaja janë të mirëseardhura.

Publikimi është përgatitur nga:

Ilir T. Berisha - Drejtor i Departamentit
Hysni Elshani – Shef i sektorit të statistikave ekonomike
Luljeta Krasniqi - Çela – Zyrtare e lartë
Valdete Navakazi - Zyrtare e lartë
Muhamet Kastrati - Menaxher i bazës së të dhënave të RSB-

Qershor, 2012

Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së,
z. Isa Krasniqi

Lista e shkurtesave

ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ASN	-	Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve
BPV	-	Bruto Produkti Vendor
MEF	-	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MTI	-	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
NVE	-	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike
ATK	-	Administrata Tatimore e Kosovës
ARBK	-	Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë
:	-	Shifrat mungojnë
n/a	-	Nuk aplikohet

Përmbajtja

	Faqe
1 Objektivi, metodologjia dhe shtrirja e anketës.....	5
1.1. Objektivi.....	5
1.2. Metodologjia dhe shtrirja e anketës.....	5
1.3. Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike (NVE).	6
1.4. Korniza për mostër dhe përzgjedhja e mostrës.....	6
1.5. Dizajnimi dhe përmbajtja e pyetësorit	7
1.6. Procedurat e mbledhjes së të dhënave.....	8
1.7. Ngritja e të dhënave të anketës strukturore të ndërmarrjeve në nivel të vendit	8
2 Definicione, përkufizime dhe treguesit themelorë.....	9
2.1. Definicione dhe përkufizime	9
2.2. Treguesit themelorë	9
3 Numri i ndërmarrjeve, të punësuarve dhe paga mesatare	10
3.1. Numri i ndërmarrjeve sipas aktiviteteve ekonomike për vitet 2008 - 2010	10
3.2. Numri i të punësuarve sipas aktiviteteve ekonomike për vitet 2008 - 2010	11
3.3. Paga mesatare sipas aktiviteteve ekonomike nga ASN-ja.....	13
4 Qarkullimi, shpenzimet	14
4.1. Qarkullimi	14
4.2. Shpenzimet	15

1 Objektivi, metodologjia dhe shtrirja e anketës

1.1. Objektivi

Objektivi kryesor i Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve (ASN) është paraqitja e strukturës së aktiviteteve ekonomike në Kosovë nëpërmjet disa treguesve ekonomik .Të mundësojë krahasueshmërinë e të dhënave në nivel ndërkombëtar duke pasur parasysh standardet Eurpoiane për statistikat strukturore dhe Sistemin European për llogarit kombëtare.

Rezultatet e të dhënave nga ASN janë burim i rëndësishëm i përpilimit të Bruto Produktit Vendor të Kosovës me qasjen e prodhimit. Anketa synon t'i plotësojë kërkesat për informacion më të plotë statistikor në kushtet e ekonomisë së tregut dhe ofron të dhëna mbi aktivitetin ekonomik e financiar të ndërmarrjeve që ushtrojnë aktivitet në të gjithë territorin e vendit.

1.2. Metodologjia dhe shtrirja e anketës

Metodologjia e përdorur për përpilimin e instrumenteve për anketë, nomenklatura dhe përgatitja e të dhënave për publikim, është sipas rregullave dhe rekomandimeve të EU-së - EUROSTAT- it.

Pyetësi është rishikuar çdo vit me qëllim të rritjes së cilësisë së të dhënave dhe përafrimin për plotësimin e kërkesave të EUROSTAT-it me qëllim që të dhënat të jenë të krahasueshme me vendet tjera.

Anketa është kryer në tërë territorin e Kosovës dhe përfshinë të dhënat për këto aktivitete ekonomike si: industri nxjerrëse (miniera, gurthyes dhe separacione të zhavorrit), industri përpunuese, prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike,e gazit, e avullit dhe ujit, ndërtim, tregti, hotele dhe restorante, transport dhe telekomunikacion, shërbime biznesi dhe shërbime tjera. Në anketë nuk përfshihen këto degë: bujqësia,gjuetia dhe pylltaria, peshkimi, financat dhe administrata publike, pasi që këto degë janë pjesë e hulumtimeve tjera. Afati për grumbullimin e të dhënave nga terreni ka qenë brenda intervalit kohor prej një muaj e gjysmë deri dy muaj .

Bashkëpunimi me ndërmarrjet për realizimin e kësaj ankete ishte i kënaqshëm. Një numër i vogël i bizneseve ka refuzuar të përgjigjet në disa nga të dhënat (pyetjet), për shkak të mos-azhurnimit apo mos deklarimit të adresave të sakta nga ana e bizneseve numër i konsiderueshëm i ndërmarrjeve nuk kanë mund të gjenden. Vetëm një numër i vogël i tyre nuk kanë treguar gatishmëri të bashkëpunimit në dhënien e shënimeve.

1.3. Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike (NVE)¹.

A	Bujqësia, gjuetia dhe pylltaria
B	Peshkimi
C	Industria nxjerrëse ²
D	Industria përpunuese
E	Prodhimi, shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit, e avullit dhe ujit
F	Ndërtimi
G	Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve, motoçikletave i sendeve personale dhe pajisjeve shtëpiake
H	Hotelet dhe restorantet
I	Transporti dhe telekomunikacioni
J	Ndërmjetësimi financiar
K	Pasuritë e patundshme, dhënia me qira, informatika dhe shërbime për ndërmjetësim
M	Arsimi
N	Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale
O	Aktivitetet të tjera të shërbimit kolektiv, social dhe personal
P	Shërbime shtëpiake
Q	Aktivitetet të organizmave ndërkombëtare

1.4. Korniza për mostër dhe përzgjedhja e mostrës

Për krijimin (përcaktimin) e kornizës së mostrës janë shfrytëzuar të dhënat nga : Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) kryesisht për përcaktimin e kornizës së mostrës bazuar në qarkullimin vjetor të ndërmarrjeve dhe numrit të të punësuarve.

Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) MTI – (adresa, pronari, telefoni) dhe aktivitetet ekonomike të koduara sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE 1) (“NACE Rev 1” ang). Veprimtaritë më vonë janë azhurnuar me të dhëna nga anketa.

Të dhënat nga Administrata Tatimore e Kosovës kanë qenë bazë për përcaktimin e kornizës së mostrës. Të gjitha ndërmarrjet që kanë deklaruar njërin nga tatimet gjatë viteve referuese për vitet paraprake janë konsideruar aktive, kështu p.sh. për ASN - 2008 aktive janë konsideruar të gjitha ato ndërmarrje të cilat kanë deklaruar njërin nga këto tatime gjatë vitit. Bazuar në këtë, 41117 ndërmarrje janë konsideruar aktive gjatë vitit 2008.

Të dhënat nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë kanë shërbyer për: adresën e ndërmarrjes, aktivitetin kryesor sipas NACE Rev.1 emrin e pronarit ose personit kontaktues, numrin e telefonit (për këtë qëllim janë shfrytëzuar edhe regjistra të ndryshëm telefonik, të dhënat nga anketat e viteve paraprake).

Përzgjedhja e mostrës është bërë në bazë të dy kritereve

- Kriteri i parë, ka qenë gjithë përfshirja e ndërmarrjeve me qarkullim vjetor mbi 50 000 euro në vit dhe

¹ Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike (NVE) është mjet statistikor për klasifikimin e ndërmarrjeve sipas aktivitetit të tyre ekonomik, shërben për përpunimin e të dhënave statistikore dhe ka gjetur zbatim në të gjitha vrojtimet pranë ndërmarrjeve.

- Kriteri i dytë gjithë përfshirja e ndërmarrjeve që nuk e kanë plotësuar kriterin e parë, por kanë pas numër të të punësuarve 10 e më tepër, përfshirë edhe pronarët të cilët punojnë, punëtorët me pagesë dhe punëtor anëtar të familjes.

Paraqitja tabelore e numrit të ndërmarrjeve dhe madhësisë së mostrës për ASN sipas viteve.

Popullacioni i ndërmarrjeve sipas viteve		2008	2009	2010
1	Korniza (Popullimi)	41117	42079	41362
2	Mostra	3677	3677	2310
3	Madhësia e mostrës %	8.8	8.7	5.6
	Përgjigje (a+b)	2236	2310	1572
4	a) Përgjigje të kompletuara	2231	2279	1557
	b) Me përgjigje jo complete	5	31	15
5	Norma e përgjigjeve %	60.8	62.0	67.0
6	Pa përgjigje*	1441	1367	738

1.5. Dizajnimi dhe përmbajtja e pyetësorit

Varësisht prej nevojave të të dhënave është bërë edhe përgatitja e pyetësorit. Plotësimi i kërkesave për llogaritë Kombëtare respektivisht përpilimin e bruto produktit vendor në qasjen e prodhimit, ka qenë qëllimi kryesor.

Pyetësori i përdorur për grumbullimin e informacionit pranë ndërmarrjeve është konceptuar në 2 pjesë kryesore :

- **Rubrika e përbashkët**, me të dhëna të përgjithshme për të gjitha ndërmarrjet.
- **Rubrika specifike**, e cila përmban tregues specifik për çdo aktivitet ekonomik.

Fillimisht *pjesa e parë* ka qenë identifikimi i ndërmarrjes me të dhëna si: numri i regjistrimit të biznesit, numri fiskal, emri i biznesit, përshkrimi i aktivitetit ose aktivitetëve nëse ka pasur dy a më tepër aktivitete, adresa e saktë, emri i pronarit, gjegjësisht pronarëve, personi kontaktues dhe koha kur është kryer anketa.

Pjesa e dytë specifike është ndarë sipas tabelave apo në kapituj ;

Kështu tabela e parë përmban : Numrin e muajve aktivë të ndërmarrjes

Tabela e dytë përmban: numrin e të punësuarve, numrin e pronarëve që punojnë, numrin e anëtarëve të familjes që punojnë pa pagesë dhe numrin e të punësuarve me pagesë. Të gjitha këto të ndara në kategori sipas gjinisë².

Tabela e tretë ka të bëjë me koston e personelit, pagat dhe mëditjet duke përfshirë edhe pjesën e pensioneve që ndërmarrja i paguan për të punësuarit³.

Tabela e katërt ka të bëjë me qarkullimin e ndërmarrjeve dhe atë për mallrat e prodhuara nga ndërmarrja, mallrat nga tregtia dhe shërbimet si dhe nën-kontraktuesit. Në fund të pyetësorit për ndërmarrjet që kanë pasur dy e më tepër aktivitete ekonomike është shtuar si aneks i kapitullit të katërt IV, si IVA për informim analitik me qëllim të identifikimit të aktivitetit kryesor dhe aktivitetëve tjera.

² Kjo ndarje është kryer për nevoja të statistikave gjinore.

³ Në bazë të ligjit mbi pensionet në Kosovë ndërmarrja është e obliguar që të paguaj për pension (min) 5% të pagës bruto dhe në baza vullnetare deri në 15% të pagës bruto

Tabela e pestë përshinë blerjet që ndërmarrja ka kryer për zhvillimin e aktivitetit ekonomik. Në këtë tabelë përfshihen shpenzimet e ndërmarrjes duke zbritur pagat dhe mëditjet, blerjet për qëllime të investimeve, minus tatimet e paguara dhe pagesat tjera që nuk janë në funksion të prodhimit si p.sh dënimet gjyqësore etj.

Tabela e gjashtë ka të bëjë me tatimet, taksat dhe licencat e paguara nga ndërmarrja për periudhën brenda viti kalendarik.

Tabela e shtatë ka të bëjë me ndryshimin e gjendjes së stoqeve për; repromaterial, karburante pajisje të vogla, për mallrat e blera për rishitje, për gjysmë prodhime dhe për prodhime finale.

Tabela e tetë ka të bëjë me investimet kapitale dhe ato të kategorizuara si në : tokë, ndërtesa dhe ndërtime, makineri dhe pajisje, përfshirë edhe kompjuterët, vetura dhe mjete tjera të transportit dhe ndërtime apo prodhime për nevojat e tyre.

Tabelat prej nëntë deri në dymbëdhjetë kanë të bëjnë me ndërmarrjet apo bizneset varësisht se cilit sektor të veprimtarive ekonomike i përkasin.

Me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të anketës në tërësi, faqja e fundit e pyetësorit është paraparë për vërejtje dhe komente të të intervistuarve që kryesisht kanë qenë kontabilistët e ndërmarrjeve.

1.6. Procedurat e mbledhjes së të dhënave

Në mbledhjen e të dhënave ne kemi aplikuar metodat të cilat i kemi konsideruar më efikase për kushtet tona.

Anketimi kryesisht është kryer me metodën e intervistimit të drejtpërdrejt nga anketuesit e ASK-së apo operatorit ekonomik. Shpërndarja e materialit në ndërmarrje si dhe mbulimi i terrenit për ASN 2008 dhe 2009 është bërë përmes operatorit ekonomik dhe mbështetjes nga punëtorët e zyrave tona Regjionale ndërsa ASN 2010 është realizuar nga ana e ASK – së.

Pas kontaktimit me personat përgjegjës pranë ndërmarrjeve duke ua sqaruar ecurinë dhe mënyrën e plotësimit të pyetësorëve me qëllim të familjarizimit sa më të mirë me përmbajtjen të njëjtit u janë lënë dhe është caktuar data apo koha për t'i plotësuar së bashku. Në raste të caktuara pyetësorët u janë lënë personave përgjegjës pranë ndërmarrjeve me qëllim të plotësimit të tyre dhe pas disa ditëve të njëjtit të plotësuar janë marrë nga anketuesit. Vetëm tek një numër i vogël i ndërmarrjeve mundësitë për mbledhjen e të dhënave në mënyrë elektronike janë zbatuar (e - mail).

1.7. Ngritja e të dhënave të anketës strukturore të ndërmarrjeve në nivel të vendit

Me qëllim të përfitimit të rezultateve nga anketa strukturore e ndërmarrjeve në nivel të vendit, të dhënat bazike nga anketat janë ngritur duke përdorur koeficientet. Këta koeficient janë kalkuluar si raport i qarkullimit të ndërmarrjeve nga ASN për aktivitetet e caktuara dhe qarkullimit të përgjithshëm të të njëjtave aktivitete bazuar nga të dhënat e ATK-së. Për verifikim të rezultateve të fituara sipas degëve janë përdorur edhe tregues tjerë si p.sh. numri i të punësuarve të deklaruar në ATK, llojet e caktuara të tatimeve të paguara etj.

2 Definicione, përkufizime dhe treguesit themelorë

2.1. Definicione dhe përkufizime

Ndërmarrja është njësia më e vogël e kombinimit të njësisë legale me njësinë e prodhimit të produkteve ose shërbimeve e cila ka pavarësi në vendim-marrje, sidomos për përdorimin e burimeve të saj materiale e monetare. Një ndërmarrje mund të ushtrojë një ose disa aktivitete ekonomike.

Të punësuarit përfshijnë të gjithë personat që punojnë në ndërmarrje përfshirë pronarët, të punësuarit me pagesë si dhe pjesëtarët e familjes të papaguar.

Vlera e qarkullimit përfshin shumat e faturuara nga ndërmarrja gjatë periudhës referuese dhe i korrespondon shitjes në treg të të mirave dhe shërbimeve të ofruar të tjerëve.

Shpenzimet apo blerjet paraqesin shumën apo vlerën totale të blerjeve të realizuara nga ana e ndërmarrjes për nevoja të afarizmit brenda vitit kalendarik .

2.2. Treguesit themelorë

Numri i ndërmarrjeve aktive brenda tre viteve ka qenë pothuaj i përafërt dhe është sjell në mes të 41 mijë deri 42 mijë si dhe me një numër prej afërsisht 89 mijë deri 115 mijë të punësuarish . Ku nga numri i përgjithshëm i të punësuarve në të gjitha sektorët e veprimtarive ekonomike vetëm në sektorin e tregtisë gjatë tri viteve ishin të punësuar 29.88 - 30,86 % e tyre .

Ndërmarrjet tregtare ku numri i tyre është në mes të 19755 - 21105 nga numri i përgjithshëm përgjatë tri viteve dhe me një përqindje prej 48.1 – 50.6% dominojnë në ekonominë Kosovare.

Gjatë viteve 2008 - 2010, numri i ndërmarrjeve në aktivitetet ekonomike të industrisë nxjerrëse gjegjësisht (minierat, gurthyesit dhe separacionet e zhavorrit), industrisë përpunuese, prodhimi, shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit, e avullit dhe ujit si dhe ndërtimtarisë arrijnë rreth 7 mijë ndërmarrje dhe punësojnë rreth 38% të totalit të të punësuarve. Çka na jep të nënkuptojmë se përkundër pjesëmarrjes së ulët të këtyre sektorëve në numrin e përgjithshëm të ndërmarrjeve ato arrijnë të punësojnë një përqindje relativisht të madhe të te punësuarve.

3 Numri i ndërmarrjeve, të punësuarve dhe paga mesatare

3.1. Numri i ndërmarrjeve sipas aktiviteteve ekonomike për vitet 2008 - 2010

Gjatë viteve 2008 - 2010 në bazë të kriterit të deklarimit të njërit nga tatimet ,numri i ndërmarrjeve aktive ka qenë ndërmjet 41000 dhe 42000. Ky numër është konsideruar kornizë për mostër për ASN 2008 - 2010. Në këtë numër nuk janë të përfshira këto aktivitete: bujqësia, pylltaria, peshkimi, financat si dhe administrata publike.

Tabela 1. Numri i ndërmarrjeve sipas aktiviteteve ekonomike në bazë të ATK-së


Seksionet	Përshkrimi i aktivitetit ekonomik	2008	2009	2010
C	Industria nxjerrëse	207	200	205
D	Industria përpunuese	4313	4353	4356
E	Prodhimi,shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit,e avullit dhe ujit	50	56	68
F	Ndërtimtaria	2297	2390	2474
G	Tregtia me pakicë dhe shumicë, riparimi i automjeteve dhe paisjeve shtëpiake	20795	21105	19755
H	Hotelet & Restorantet	3498	3559	3364
I	Transporti, postat dhe telekomunikacioni	3610	3655	3377
K	Shërbime biznesore	3846	4197	4112
O	Shërbime tjera	2501	2564	3345
Gjithsej		41117	42079	41056

Tabela 2. Struktura e ndërmarrjeve sipas aktiviteteve ekonomike

Seksionet	Pershkrimi i aktivitetit ekonomik	2008	2009	2010
C	Industria nxjerrëse	0.5	0.5	0.5
D	Industria përpunuese	10.5	10.3	10.6
E	Prodhimi,shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit,e avullit dhe ujit	0.1	0.1	0.2
F	Ndërtimtaria	5.6	5.7	6.0
G	Tregtia me pakicë dhe shumicë, riparimi i automjeteve dhe paisjeve shtëpiake	50.6	50.2	48.1
H	Hotelet & Restorantet	8.5	8.5	8.2
I	Transporti, postat dhe telekomunikacioni	8.8	8.7	8.2
K	Shërbime biznesore	9.4	10.0	10.0
O	Shërbime tjera	6.1	6.1	8.1
Gjithsej		100	100	100

Vërehet se pjesa më e madhe e ndërmarrjeve deklaruese gjatë tri viteve i përkasin sektorit të tregtisë (në mes 48.1 dhe 50.6 %). Pjesa tjetër janë nga sektorët: Industri (në mes 10.3-10.6%), transport, postë dhe telekomunikacion (në mes 8.2 dhe 8.8%), Hotele&Restorante (në mes të 8.2 dhe 8.5%), Ndërtimtari (5.6 – 6.0%), shërbime biznesore (9.4- 10%), shërbime tjera (6.1 – 8.1%) etj. Një strukturë ndryshe nga kjo është ajo për numrin e të punësuarve sipas degëve ekonomike.

Grafikoni 1. Struktura e ndërmarrjeve sipas aktiviteteve ekonomike 2008 - 2010



3.2. Numri i të punësuarve sipas aktiviteteve ekonomike për vitet 2008 - 2010

Numri i përgjithshëm i të punësuarve gjatë vitit 2008 – 2010 ka qenë ndërmjet 89 mijë dhe 115 mijë. Në këtë numër nuk bëjnë pjesë të punësuarit në sektorët e veprimtarive ekonomike: bujqësi, pylltari, peshkim, financa kompani të sigurimeve dhe administratë publike.


Tabela 3. Numri i të punësuarve sipas aktiviteteve ekonomike nga ASN-ja

Seksionet	Pershkrimi i aktivitetit ekonomik	2008	2009	2010
C	Industria nxjerrëse	2964	3823	3720
D	Industria përpunuese	17505	18107	19272
E	Prodhimi, shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit, e avullit dhe ujit	8926	9630	9893
F	Ndërtimtaria	7219	10268	13660
G	Tregtia me pakicë dhe shumicë, riparimi i auomjeteve dhe paisjeve shtëpiake	27112	31350	35421
H	Hotelet&Restuarantet	6478	6992	7432
I	Transporti, postat dhe telekomunikacioni	8244	9832	10445
K	Shërbime biznesore	6859	10014	10177
O	Shërbime tjera	3544	4717	5100
Gjithsej		88851	104734	115120

Tabela 4. Struktura e të punësuarve sipas aktiviteteve ekonomike nga ASN-ja (%)

Seksionet	Përshkrimi i aktivitetit ekonomik	2008	2009	2010
C	Industria nxjerrëse	3.3	3.7	3.2
D	Industria përpunuese	19.7	17.3	16.7
E	Prodhimi, shpërndarja e nergjisë elektrike, e gazit, e avullit dhe ujit	10.0	9.2	8.6
F	Ndërtimtaria	8.1	9.8	11.9
G	Tregtia me pakicë dhe shumicë, riparimi i automjeteve dhe paisjeve shtëpiake	30.5	29.9	30.8
H	Hotelet & Restorantet	7.3	6.7	6.5
I	Transporti, postat dhe telekomunikacioni	9.3	9.4	9.1
K	Shërbime biznesore	7.7	9.6	8.8
O	Shërbime tjera	4.0	4.5	4.4
Gjithsej		100	100	100

Sa i përket strukturës së të punësuarve sipas aktiviteteve ekonomike përsëri vërehet se pjesa më e madhe janë në sektorin e tregtisë dhe sillet në mes të 29.9 dhe 30.8%. Tregtia në Kosovë karakterizohet me numër të madh të ndërmarrjeve të vogla me pak të punësuar, kryesisht janë biznese familjare me një të punësuar apo të vetëpunësuar edhe pse në këtë sektor kemi disa ndërmarrje të cilat punësojnë 100 e më tepër të punësuar. Të punësuarit tjerë janë kryesisht në sektorin e industrisë përpunuese (16.7 – 19.7%), sektorin e energjisë (8.6 - 10.0%), Ndërtimtari (8.1 – 11.9%), Transport, postë dhe telekomunikacion me (9.1 - 9.4%) e kështu me radhë.

Grafikoni 2. Të punësuarit sipas aktiviteteve ekonomike për vitet 2008 - 2010

3.3. Paga mesatare sipas aktiviteteve ekonomike nga ASN-ja

Paga mesatare është një tregues me rëndësi. Ajo është kalkuluar duke pjesëtuar pagat dhe mëditjet bruto⁴ sipas viteve fillimisht me numrin e të punësuarve e pastaj me 12 (muajt e vitit)


Tabela 5. Paga mesatare sipas aktiviteteve ekonomike – ASN 2008 – 2010

Seksionet	Përshkrimi i aktivitetit ekonomik	2008	2009	2010
C	Industria nxjerrëse	347	355	381
D	Industria përpunuese	224	224	223
E	Prodhimi, shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit, e avullit dhe ujit	440	424	501
F	Ndertimtaria	215	220	226
G	Tregtia me pakicë dhe shumicë, riparimi i automjeteve dhe paisjeve shtëpiake	218	207	206
H	Hotelet & Restorantet	208	217	221
I	Transporti, postat dhe telekomunikacioni	526	532	537
K	Shërbime biznesore	232	236	255
O	Shërbime tjera	244	248	251
Gjithsej		270	272	281

Lartësia e pagës mesatare e cila sillet nga 270 deri në 281 Euro për vitet 2008 - 2010 në aktivitetet e përfshira në anketë është një tregues i përafërt me realitetin tonë. Siç edhe mund të vërehet paga mesatare më e lartë është në sektorin e postë dhe telekomunikacionit, derisa ajo më e ulëta është në sektorin e hotelerisë dhe restoranteve.

Në bazë të grafikut vërejmë se niveli i pagave nëpër vite tek të gjitha seksionet e aktiviteteve ekonomike është shumë i përafërt.

Grafikoni 3. Paga mesatare sipas aktiviteteve ekonomike për ASN 2008 – 2010



⁴ Në pagën bruto është konsideruar edhe pjesa e pensionit që pronari paguan për punëtorin.

4 Qarkullimi, shpenzimet

4.1. Qarkullimi


Vlera e qarkullimit përfshinë shumat e faturuara nga ndërmarrja gjatë periudhës së marrë në shqyrtim dhe i korrespondon shitjes në treg të të mirave dhe shërbimeve ofruar të tjerëve.

Tabela 6. Struktura e qarkullimit sipas aktiviteteve ekonomike për ASN 2008 – 2010

Seksionet	Përshkrimi i aktivitetit ekonomik	2008	2009	2010
C	Industria nxjerrëse	3.2	2.9	2.8
D	Industria përpunuese	12.3	11.3	11.4
E	Prodhimi, shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit, e avullit dhe ujit	4.9	4.7	5.3
F	Ndërtimtaria	9.3	10.0	9.7
G	Tregtia me pakicë dhe shumicë, riparimi i automjeteve dhe paisjeve shtëpiake	55.6	57.2	57.1
H	Hotelet & Restorantet	1.2	1.1	1.1
I	Transporti, postat dhe telekomunikacioni	8.8	7.9	7.6
K	Shërbime biznesore	3.7	3.9	3.9
O	Shërbime tjera	1.0	0.9	1.0
Gjithsej		100	100	100

Qarkullimi i realizuar nga ndërmarrjet sipas viteve vërejmë së është në relacion me numrin e ndërmarrjeve sipas seksioneve të aktiviteteve ekonomike. Kështu vlera e qarkullimit të realizuar nga sektori i tregtisë sillet në mes të 55.6 dhe 57.2 % dhe kryesisht ka të bëjë me ndërmarrje të mesme, kurse sektorët e tjerë të veprimtarive ekonomike rezultojnë me një përqindje më të vogël të qarkullimit. Kështu sektorët të cilët kanë përqindje më të vogël të qarkullimit janë hotelet dhe restorantet me 1.1 – 1.2% dhe shërbimet tjera me 0.9 -1.0%.

Grafikoni 4. Qarkullimi sipas aktiviteteve ekonomike për ASN 2008 - 2010




4.2. Shpenzimet

Tabela 7. Shpenzimet në bazë të aktiviteteve – ASN 2008 – 2010

Seksionet	Përshkrimi i aktivitetit ekonomik	2008	2009	2010
C	Industria nxjerrëse	1.8	2.2	2.6
D	Industria përpunuese	13.0	10.2	13.6
E	Prodhimi, shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit, e avullit dhe ujit	5.2	5.0	5.1
F	Ndertimtaria	8.7	8.8	9.3
G	Tregtia me pakicë dhe shumicë, riparimi i automjeteve dhe paisjeve shtëpiake	59.1	63.3	57.8
H	Hotelet & Restorantet	1.1	0.9	1.0
I	Transporti, postat dhe telekomunikacioni	7.2	6.0	6.7
K	Shërbime biznesore	3.1	2.8	3.2
O	Shërbime tjera	0.7	0.7	0.8
Gjithsej		100	100	100

Duke u bazuar në anketën strukturore të biznesit sipas viteve 2008 - 2010 vërejmë se edhe tek shpenzimet apo blerjet dominante është seksioni i tregtisë me përqindje në mes të 57.8 - 63.3% të vlerës totale të të gjitha aktiviteteve. Bazuar nga të dhënat më lartë shohim se shpenzimet më të vogla janë tek restorantet 0.9-1,1% dhe në shërbimet tjera 0,7-0.8%, çka edhe është reale dhe në proporcion me numrin e ndërmarrjeve .

Grafikoni 5. Shpenzimet sipas aktiviteteve ekonomike për ASN 2008 - 2010



Agjencia e statistikave të Kosovës

përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Plani zhvillimor strategjik 2009-2013 është në implementim afatmesëm për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: **Departamentet prodhuese;** (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të popullsisë, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. **Departamentet mbështetëse;** (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti i administratës. **Në kuadër të Agjencionit vepron edhe;** Zyra për regjistrimin e popullsisë ekonomike familjare dhe banesave si dhe **Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Numri i të punësuarve dhe buxheti akoma janë të limituar. Të punësuar janë gjithsej 134 punëtorë, prej tyre, 96 (71.6%) në seli të Entit, gjersa në Zyrat Rajonale, 38 (28.4%), Enti ka këtë strukturë kualifikuese, 65.4% me shkollim universitar ndaj 34.6% me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikave të shteteve në rajon.

Agjencia e statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njësive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Kemi realizuar me sukses në vitin 2011 projektin e Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe banesave, i cili regjistrim nuk është realizuar që nga viti 1981. Rezultatet e fituara nga ky regjistrim do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- o **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- o **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 143
Kryeshefi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- o **Fax::** +381 (0) 38 235 033
- o **E-mail:** economic@ks-gov.net
- o **Ueb-faqe:** <http://esk.rks-gov.net>